

2014

STRATEGJI KOMUNIKIMI E GJYKATËS THEMELORE TË PRIZRENIT

Strategjia e komunikimit është një nismë e re dhe përpjekje për të përmirësuar cilësinë e punës së Gjykatës Themelore të Prizrenit, për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe informimin e qytetarëve, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë së shërbyesve të drejtësisë ndaj qytetarëve.

Gjykata Themelore e Prizrenit

www.kgjk-ks.org

2014



GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT

STRATEGJI KOMUNIKIMI E GJYKATËS THEMELORE TË PRIZRENIT

2014, PRIZREN



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



*Ky dokument është hartuar nga EC Ma Ndryshe për Gjykatën Themelore të Prizrenit, në kuadër të projektit **Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë**, që përkrahet financiarisht nga USAID dhe mbikëqyret nga ATRC.*

"Ky dokument u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbytja është përgjegjësi e EC Ma Ndryshe dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara".

PËRMBAJTJE

| | |
|----------------------|----|
| HYRJE | 5 |
| SFIDAT | 7 |
| OBJEKTIVAT | 10 |
| AUDIENCAT | 11 |
| QASJA DHE MESAZHET | 13 |
| MJETET DHE AKTIVITET | 15 |
| PLANI I VEPRIMIT | 19 |
| PËR GJYKATËN | 21 |

HYRJE

Strategjia e komunikimit është një nismë e re dhe përpjekje për të përmirësuar cilësinë e punës së Gjykatës Themelore të Prizrenit, për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe informimin e qytetarëve, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë së shërbyesve të drejtësisë ndaj qytetarëve.

Qytetarët dhe shërbyesit e drejtësisë në Prizren dëshirojnë të kenë një gjykatë transparente, efektive dhe të përgjegjshme. Kjo do të ndikonte në fuqizimin e lidhjes mes qytetarëve dhe shërbyesve të drejtësisë, dhe rrjedhimisht do të ndikonte në ngritjen e besimit tek institucionet gjyqësore. Transparenca dhe komunikimi me qytetarët do të mundësojë që gjykata të forcojë besimin e qytetarëve tek organet e drejtësisë.

Përpilimi i kësaj strategjie vërteton qasjen e re të Gjykatës Themelore të Prizrenit, si dhe ka për qëllim që të vë në zbatim planet konkrete për të nxitur transparencën, të krijoj një lidhje të fuqishme me qytetarët dhe të vë në përdorim mjetet dhe teknologjitë e reja për të forcuar lidhjen e gjykatës me qytetarët.

Kjo strategji komunikimi do të udhëzoj punën tre vjeçare të Gjykatës Themelore të Prizrenit dhe për të arritur objektivat e lartpërmendura, gjykata do të bashkëpunoj ngushtë me organizatën EC Ma Ndryshe në zbatimin e veprimeve të vitit të parë të strategjisë.

Dokumenti i strategjisë është strukturuar rreth këtyre kapitujve:

- **Sfidat kryesore të gjykatës**

- o Nevojë për gjyqtarë shtesë; Mungesë e stafit administrativ; Infrastrukturë e pamjaftueshme; Mungesë e bashkëpunëtorëve profesional; Praktikantët e gjykatës; Takimet e Kryetarit me qytetarë; Komunikimi elektronik;

Raportimi medial për punën e gjykatës; dhe Bashkëpunimi me shkollat.

- **Objektiva e Strategjisë**
 - o Qëllimi themelor i stragjisë së komunikimit është të rrisë pjesëmarrjen dhe besimin e qytetarëve në sektorin e drejtësisë, me fokus në Gjykatën Themelore të Prizrenit.
- **Audienat e synuara**
 - o Mediat (lokale dhe qendrore), studentët e universiteteve (kryesisht të Juridikut), nxënësit e shkollave të mesme të Prizrenit, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë (gratë, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta).
- **Qasja dhe Mesazhet**
 - o Gjykata si pjesë e zbatimit të strategjisë së komunikimit do të shërbehet me këto mesazhe (porosi): Gjykatë e Hapur, Gjykata më afër qytetarit, Lidhja e qytetarit me shërbyesit e drejtësisë, Gjykatë transparente, Qytetarët pjesë e sistemit të drejtësisë, Komunikim i përhershëm me qytetarin.
- **Mjetet dhe Aktivitetet**
 - o Monitorim i mediave, Web portali, Profile në rrjete sociale, Broshura informative, Spoti televiziv, Takime të rregullta me qytetarët, Takime të rregullta me gazetarët, Konferencat për shtyp, Programe “vizito gjykatën”, Buletini informativ, Ngjarje tematike, Storit e suksesit, dhe Praktikantët e Zyres së Informimit.
- **Plani i Veprimit**
 - o Me detaje rreth aktiviteteve, përgjegjësve, partnerëve dhe afateve kohore.

SFIDAT

Gjykata Themelore e Prizrenit përballet me një numër sfidash të natyrave të ndryshme, të cilat në mënyrë direkte ose indirekte ndikojnë në marrëdhënien e saj me publikun. Sfidat me të cilat përballet gjykata duhet të trajtohen me kujdes dhe mbi këtë analizë të ndërtohen edhe objektivat, mjetet e veprimit dhe aktivitetet e strategjisë për komunikim me publikun.

Nevojë për gjyqtarë shtesë

Numri i vogël i gjyqtarëve dhe i stafit administrativ është sfidë e përbashkët e të gjitha gjykatave në Kosovë. Megjithatë, marrë parasysh territorin që mbulon, nevojat për gjyqtarë shtesë të Gjykatës Themelore të Prizrenit bëhen më të theksuara. Numri i vogël i gjyqtarëve ndikon në performansën e përgjithshme të punës së gjykatës, dhe rrjedhimisht edhe në besimin e qytetarëve ndaj gjyqësisë në përgjithësi. Edhe pse me numër të pamjaftueshëm gjyqtarësh (në raport me numrin e lëndëve), gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Prizrenit angazhohen mbi normën e caktuar dhe i vënë në dispozicion të gjitha kapacitetet për të përmalluar numrin e madh të lëndëve.

Mungesë e stafit administrativ

Krahas nevojës për gjyqtarë shtesë, Gjykata Themelore sfidohet edhe nga numri i pamjaftueshëm i stafit administrativ. Stafi administrativ luan rol qenësor në gjithë ciklin e shqyrtimit të lëndëve dhe ka ndikim të madh në funksionimin e përgjithshëm të gjykatës. Numri i vogël i stafit administrativ vështirëson në mënyrë të theksuar punën e gjykatës dhe cënon efikasitetin e punës së saj.

Infrastrukturë e pamjaftueshme

Gjykata Themelore sot operon në hapësira fizike të cilat nuk i plotësojnë nevojat për punë efikase. Në veçanti, numri dhe hapësira e vogël e sallave të gjykimit dhe mungesa e pajisjeve të nevojshme teknike, sfidojnë seriozisht punën e gjykatës. Gjykata ka nevojë për më shumë hapësira profesionale, të cilat do të lehtësonin punën e gjyqtarëve dhe stafit administrativ dhe në të njëjtën kohë do të ofronin shërbime adekuate qytetarëve.

Mungesë e bashkëpunëtorëve profesional

Në veçanti, Gjykata Themelore e Prizrenit sfidohet nga mungesa e bashkëpunëtorëve profesional dhe kufizimet e natyrave të ndryshme (kryesisht financiare) për të angazhuar profesionistë që do të duhej t'ia shtonin kredibilitetin profesional punës dhe vendimeve të gjykatës. Gjykata ka nevojë urgjente për kapacitete shtesë profesionale dhe kjo do të duhej të arrihej përmes gjetjes së formave për të kontraktuar shërbime nga bashkëpunëtorët profesional.

Praktikantët e gjykatës

Ndonëse gjykata angazhon praktikantë kohë pas kohe, kjo praktikë nuk është shndërruar ende në një sistem permanent dhe funksional të përfitimit nga praktikantët. Gjykata ka mundësi të kufizuara financiare për komponentën e praktikantëve të gjykatës dhe rrjedhimisht ka pas masa stimuluese për angazhimin e praktikantëve.

Takimet e Kryetarit me qytetarë

Qytetarët e Prizrenit kanë njohuri të kufizuara për punën e Gjykatës Themelore të Prizrenit, e në veçanti për mundësitë që iu ofrohen atyre. Një nga mundësitë pak të njohura nga qytetarët janë takimet e Kryetarit

të gjykatës me qytetarë, të cilat mbahen dy herë në muaj dhe kanë orarin e tyre të caktuar. Këto takime janë mundësi e mirë që qytetarët t'i adresojnë shqetësimet e tyre para Kryetarit të gjykatës, prandaj edhe ka nevojë për promovimin e kësaj mundësie.

Komunikimi elektronik

Gjykata ende nuk e ka web-faqen e saj dhe kjo është ndër pengesat kryesore për informimin publik. Qytetarët, gazetarët dhe palët e treta nuk e kanë mundësinë që përmes një web-faqeje të marrin informacionin e duhur në mënyrë efektive dhe kohë të shkurtër. Në të njëjtën kohë, gjykata përdot shumë pak edhe mundësitë e tjera të komunikimit elektronike (online) me publikun. Mjetet e medias sociale (FB, Twitter, etj.) nuk janë zhvilluar ende.

Raportimi medial për punën e gjykatës

Mediat e Prizrenit raportojnë për Gjykatën Themelore të Prizrenit vetëm atëherë kur ka lajme negative (rastet e korrupsionit dhe krimet, si dhe problemet me punën e gjykatës). Raportimi i bazuar në lajme kryesisht negative ndikon edhe në perceptimin dhe besimin publik ndaj gjykatës. Gjykata ende nuk e ka zhvilluar një strategji të komunikimit me median, për t'u siguruar që edhe rezultatet pozitive të punës së gjykatës gjejnë hapësirë të duhur mediale.

Bashkëpunimi me shkollat

Bashkëpunimi me shkollat fillore, të mesme dhe universitetet e Prizrenit është në nivel të ultë. Vetëm kohë pas kohe organizohen aktivitete të cilat synojnë rritjen e komunikimit të gjyqtarëve me nxënësit dhe studentët. Megjithatë, gjykata nuk ka një program të zhvilluar për bashkëpunim me shkollat, e sidomos me drejtimet universitare të afërta me punën e gjykatës (Juridiku).

OBJEKTIVAT

Qëllimi themelor i stragjisë së komunikimit është rrisë pjesëmarrjen dhe besimin e qytetarëve në sektorin e drejtësisë, me fokus në Gjykatën Themelore të Prizrenit. Strategjia do të zhvillojë mjete dhe shërbime adekuate të cilat do të ofrojnë hapësirën e duhur për t'i ndërlidhur qytetarët me shërbyesit e drejtësisë.

Objektivat specifik të kësaj strategjie janë:

- Përmirësimi i komunikimit mes gjykatës dhe grupeve të synuara (audiencat)
 - o Strategjia do të zhvillojë mjetet adekuate për të zhvilluar komunikimin mes qytetarëve dhe shërbyesve të drejtësisë dhe do të ketë një plan veprimi tre vjeçar
- Qasja në informacion për qytetarët e lehtësuar dhe përmirësuar
 - o Punë intensive me shkollat, mediat dhe akterët tjerë relevant për t'i shpërndarë materialet e zhvilluara mbi punën e gjykatës
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare në sektorin e drejtësisë
 - o Ky objektiv lidhet me dy objektivat e parë dhe synon prodhimin e dijes përmes mjeteve dhe produkteve të zhvilluara që do të rrisin besimin e qytetarëve në sustemin e drejtësisë.

AUDIENCAT

Strategjia sugjeron një numër të caktuar audiencash, ndërsa të rejt mund të shtohen në bazë të nevojave dhe vlerësimeve mbi zbatimin e kësaj strategjie. Audiencat kryesore dhe më strategjike të synuara përmes kësaj strategjie janë: mediat (lokale dhe qendrore), studentët e universiteteve (kryesisht të Juridikut), nxënësit e shkollave të mesme të Prizrenit, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë (gratë, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta).

Mediat – raportimi medial mbi punën e gjykatës është ndër faktorët më të rëndësishëm të ndërtimit të besimit të qytetarëve ndaj Gjykatës Themelore të Prizrenit. Për këtë arsye, gjykata do të targetojë në mënyrë specifike mediat për të zhvilluar një sistem të bashkëpunimit permanent. Fokusi i strategjisë do të jetë kryesisht në raport me mediat lokale të Prizrenit (dhe të rajonit), përfshi televizionet, radiot, gazetat dhe porrralet e lajmeve.

Studentët e universiteteve – bashkëpunimi me studentët e universiteteve në Prizren është i rëndësishëm së veçantë dhe proces me përfitim të shumëfishtë. Në rritjen e komunikimit me studentët, gjykata do të fokusohet në studentët e drejttimeve të Juridikut dhe drejttimeve tjera relevante për t'u mundësuar studentëve interaksion më të madh me gjykatën dhe njëherit për të përfituar edhe nga potenciali i tyre. Gjykata do të synojë themelimin e bashkëpunimit të strukturuar me disa universitete të Prizrenit për të realizuar aktivitete dhe programe të vetëdijesimit dhe ngritjes profesionale për studentët.

Nxënësit e shkollave të mesme – një grup me rëndësi të veçantë i shoqërisë për gjykatën janë nxënësit e shkollave të mesme (të të gjitha drejttimeve). Pasi që kjo është mosha e formësimit intelektual të të rinjve dhe njëherit periudha e planifikimit të karrierës profesionale,

gjykata synon të angazhohet në komunikim të shtuar me shkollat e mesme të Prizrenit. Ky angazhim përfshin informimin e të rinjve për punën e gjykatës, ofrimin e mundësive për të vizituar gjykatën (dhe seancat), vizitat në shkolla të shërbyesve të drejtësisë, deri tek programet e veçanta.

Organizatat e shoqërisë civile – Prizreni ka një sektor të zhvilluar të shoqërisë civile, me një numër të konsiderueshëm organizatash të profilizuara dhe me kapacitete profesionale. Gjykata do t'i ftoj organizatat e shoqërisë civile për të zhvilluar programe të partneritetit me qëllim të rritjes së informimit publik mbi punën e gjykatës përmes realizimit të projekteve të përbashkëta.

Grupet e marginalizuara të shoqërisë – për të përmbushur parimin e ofrimit të shërbimeve për të gjithë dhe në mënyrë të barabartë, gjykata do të angazhohet në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të marginalizuara të shoqërisë. Për këtë qëllim, gjykata do të krijojë kanale të përhershme të komunikimit me këto grupe dhe përfaqësuesit e tyre (gratë, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, etj.) për t'u siguruar që nevojat dhe shqetësimet e tyre merren parasysh dhe adresohen me kujdes gjatë kryerjes së punëve të gjykatës.

QASJA DHE MESAZHET

Strategjia është ndërtuar mbi tri parime themelore: pronësi, gjithpërfshirje dhe koordinim. Përmes veprimeve të dizajnuara me këtë strategji, Gjykata Themelore e Prizrenit do të ndërtojë pronësi mbi procesin e komunikimit me procesin dhe do të jetë bartëse kryesore e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit. Në zbatimin e kësaj strategjie, Gjykata do të sigurohet të ruaj qasjen gjithëpërfshirëse ndaj informimit publik, për t'i shërbyer të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë. Mbi të gjitha, në zbatimin efektiv të kësaj strategjie, Gjykata do të bashkëpunojë me hisedarë të ndryshëm, në mënyrë që sigurohet koordinimi efektiv i misionit të informimit publik me të gjitha palët e interesuara.

Gjykata Themelore e Prizrenit është e përkushtuar në rritjen e bashkëpunimit me të gjitha grupet e komunitetit dhe në zbatimin e kësaj strategjie do të jetë posaçërisht e vëmendshme në shpërndarjen adekuate të informacionit me interes publik. Gjykata beson fuqimisht në domosdoshmërinë e rritjes së informimit dhe pjesëmarrjes qytetare për të siguruar punë transparente dhe rritur cilësinë e shërbimeve të ofruara. Gjykata është dhe duhet të jetë e qytetarëve, dhe për t'u siguruar që ky parim është duke u zatur plotësisht, Gjykata do t'i angazhojë të gjitha kapacitetet e veta njerëzore dhe tenkike. Bashkëpunimi me hisedarët e tjerë është qenësor për të rritur nivelin e transparencës dhe siguruar informim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.

Në zbatimin e kësaj strategjie, Gjykata do të përdorë një numër të caktuar mesazhesh (porosish) për të komunikuar informacionin dhe për të rritur vizibilitetin e punës së saj. Edhe pse nuk do të kufizohet vetëm në këto, Gjykata si pjesë e zbatimit të strategjisë së komunikimit do të shërbehet me këto mesazhe (porosi):

- Gjykatë e Hapur,
- Gjykata më afër qytetarit,
- Lidhja e qytetarit me shërbyesit e drejtësisë,
- Gjykatë transparente,
- Qytetarët pjesë e sistemit të drejtësisë,
- Komunikim i përhershëm me qytetarin.

Mesazhet (porositë) si pjesë e komunikimit publik të Gjykatës do të përdoren varësisht nga forma dhe mjeti i komunikimit, ndërsa për ndryshimin, largimin ose përditësimin e tyre do të vendoset në varësi të raporteve vlerësuese për zbatimin e strategjisë. Në bazë të raporteve të rregullta të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë, do të bëhet edhe (ri)vlerësimi i mesazheve të përdorura.

MJETET DHE AKTIVITET

Strategjia propozon një numër mjetesh dhe aktivitete të cilat do të realizohen përgjatë periudhës tre vjeçare. Këto mjete dhe aktivitete janë hartuar në përputhje me qëllimin themelor dhe objektivat specifik të kësaj strategjie. Në dizajnimin e mjeteve dhe aktiviteteve është ndjekur një proces konsultues me zyrtarët e gjykatës dhe akterët tjerë relevantë, si dhe është konsideruar faktori i kapaciteteve ekzistuese të gjykatës për zbatimin e tyre.

Strategjia parasheh hartimin dhe zbatimin e këtyre veprimeve:

1. Monitorim i mediave – të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike (lokale dhe qendrore) do të monitorohen përmes një sistemi permanent të monitorimit. Ky proces do të mundësojë krijimin e një databaze të mbulesës mediale për punën e gjykatës dhe do të ofrojë mundësi për të analizuar natyrën e raportimeve mediale. Mbi bazën e analizave të brendshme ndaj raportimit medial, gjykata do të zhvillojë mekanizmat e vet reagues për t'u siguruar në korrektësinë e raportimit.

2. Web portali – i gjithë informacioni zyrtar mbi punën e gjykatës do të vendoset në web portalin e gjykatës. Krijimi i web portalit do të mundësonte qasje të lehtë në informacion për të gjitha palët e interesuara dhe njëherit do të ndikojë në rritjen e transparencës së gjykatës. Kjo hapësirë virtuale do të ndikojë dukshëm në efikasitetin e strategjisë së komunikimit të gjykatës, pasi që ajo do t'i përmbledhë të gjitha materialet relevante në një vend.

3. Profile në rrjete sociale – për të siguruar bartje të shpejtë dhe efektive të informacionit zyrtar të gjykatës, përveç web portalit, gjykata do të krijojë edhe profile zyrtare në rrjetet sociale si Facebook dhe

Twitter. Përmes këtyre profileve, qytetarëve do t'u ofrohet informacion në baza ditore mbi punën e gjykatës, sidomos për detajet e seancave.

4. Broshura informative – të gjitha informacionet relevante për punën e gjykatës dhe të drejtat e qytetarëve do të përmbliidhen në një broshurë informative, e cila do të shpërndahet përmes disa kanaleve. Kjo broshurë do të përdoret si material informativ në të gjitha kontaktet e zyrtarëve të gjykatës me qytetarët dhe do të jetë në dispozicion në të gjitha hapësirat e gjykatës dhe pikat e caktuara në Prizren. Broshura do të përmbajë edhe manualin “si t'i qasemi gjykatës”, udhëzues hap pas hapi për qytetarët për punën e tyre me gjykatën.

5. Spoti televiziv – për t'i targetuar audiencat e gjera, do të prodhohet spoti televiziv me përmbajtje informative. Ky spot do të transmetohet në televizionet lokale të Prizrenit dhe të synojë edukimin e qytetarëve për të drejtat e tyre karshi gjykatës.

6. Takime të rregullta me qytetarët – gjykata do të krijojë një sistem permanent të takimeve me grupet e komunitetit në Prizren për t'u siguruar që zyrtarët e saj janë në komunikim të rregullt me qytetarët. Këto takime do të realizohen në formë të vizitave informative (ligjëratave) dhe forumeve të diskutimit, ndërsa për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim nga organizatat e shoqërisë civile, forumet e studentëve, dhe grupet e tjera të organizuara të shoqërisë.

7. Takime të rregullta me gazetarët – gjykata do të përpilojë listën e gazetarëve (lokal dhe qendror) të cilët e përcjellin punën e Gjykatës Themelore të Prizrenit. Për të siguruar komunikim të rregullt me gazetatër, gjykata do të organizojë takime mujore me gazetarët, të cilët do të ftohen për takime joformale dhe konsultative në hapësirat e gjykatës. Përmes këtij komunikimi të rregullt synohet përmirësimi i raportimit medial mbi punën e gjykatës.

8. Konferencat për shtyp – çdo dy muaj, gjykata do të organizojë konferenca për shtyp, për të raportuar mbi punën e gjykatës. Për t'u siguruar që këto konferenca nuk do të përmbajnë vetëm raportime teknike mbi punën e gjykatës, gazetarëve do t'u ofrohen informacione edhe përmes: broshurës, storieve të suksesit, buletinit informativ, informatave për programet “vizito gjykatës” dhe takimeve me qytetarë.

9. Programe “vizito gjykatën” – fillimisht do të krijohen dy programe për të vizituar gjykatës, ture në gjykatë dhe takohu me stafin e gjykatës. Të dyja këto programe do të targetojnë grupe të caktuara, përfshi studentët, nxënësit e shkollave të mesme, personat me nevoja të veçanta etj, dhe do të jenë mundësi që qytetarët të shohin mjediset e punës së gjykatës, takohen me gjyqtarët, marrin pjesë në seanca, etj.

10. Buletini informativ – të gjitha informacionet relevante mbi punën e gjykatës do të përmbliidhen në buletin informativ, i cili do të publikohet çdo dy muaj. Buletini informativ do të përmbajë informacione të shkurtra dhe relevante për qytetarët (2-3 faqe) dhe do të shpërndahet në formë elektronike. Një pjesë e hapësirës së buletinit do t'i dedikohet informimit mbi veprimet e ndërmarra si pjesë e zabtimit të Strateisë së Komunikimit.

11. Ngjarje tematike – gjykata do të përpilojë listën e ditëve të rëndësishme (shtetërore dhe ndërkombëtare) të cilat kanë të bëjnë me sektorin e drejtësisë. Për të shënuar ditët e rëndësishme, gjykata do të organizojë ngjarje tematike në bashkëpunim me organizatat përkatëse. Këto ngjarje kanë për qëllim rritjen e vizibilitetit të gjykatës dhe thellimin e partneritetit me organizatat e tjera (organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare, organizatat profesionale, mediat, etj.)

12. Storiët e suksesit – një numër i madh i zhvillimeve pozitive në gjykatë kalojnë pa u vërejtur, sidomos pa u raportuar nga mediet. Për t'u siguruar që anët pozitive të punës së gjykatës u transmetohen qytetarëve, në baza periodike gjykata do të prodhojë shkrime mbi storië të suksesit (një faqe), në të cilat do të prezantohen rastet specifike, me detaje relevante për mediat dhe publikun rreth rastit dhe zgjidhjes së prodhuar si rezultat i punës së gjykatës.

13. Praktikantët e Zyres së Informimit – për të siguruar zbatim efektiv të Strategjisë, Zyra për Informim i Gjykatës, në bashkëpunim me universitetet në Prizren do të themelojë një sistem të përhershëm të rekrutimit të praktikantëve. Prioritet në përzgjedhjen e këtyre praktikantëve do të kenë studentët që kanë aftësi shkrimi, njohuri mbi mediat sociale dhe njohuri të gjuhës angleze.

14. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë – Zyra për Informim e Gjykatës do të kujdeset për monitorimin e zbatimit të dokumentit strategjik dhe për këtë qëllim do të prodhojë raporte gjashtë mujore për të vlerësuar zbatimin e Strategjisë.

PLANI I VEPRIMIT

| AKTIVITETI | PËRGJEGJËSIT | PARTNERËT | KOHA |
|---|---|--|--|
| Monitorim i mediave | Zyra për Informim Praktikantët | | Monitorimi i mediave do të realizohet në baza ditore |
| Web portali | Zyra për informim Këshilli Qjyqësor i Kosovës | | Web portali do të krijohet në TM4 2014, ndërsa përditësimi do të bëhet në baza të rregullta |
| Profile në rrjete sociale | Zyra për Informim | EC Ma Ndryshe | Profilet do të krijohen në TM3 2014, ndërsa përditësimi do të bëhet në baza të rregullta |
| Broshura informative | Zyra për Informim | EC Ma Ndryshe | Broshura do të prodhohet në TM3 2014, ndërsa shpërndarja e saj do të bëhet në baza të rregullta |
| Spoti televiziv | Zyra për informim | EC Ma Ndryshe | Spoti televiziv do të prodhohet në TM3 2014 dhe do të transmetohet në TV lokale në TM4 2014. Transmetimi për vitet 2015 dhe 2016 varet nga mundësitë buxhetore |
| Takime të rregullta me qytetarët | Zyra për Informim Stafi administrativ Gjyqtarët | Organizatat e shoqërisë civile, grupet e komunitetit | Takimet me qytetarët do të realizohen së paku në çdo TM të secilit vit |

| AKTIVITETI | PËRGJEGJËSIT | PARTNERËT | KOHA |
|---|--|---|---|
| Takime të rregullta me gazetarët | Zyra për Informim Gjyqtarët | Mediat | Takimet me gazetarët do të realizohen në baza mujore (java e fundit ose java e parë e muajit) |
| Konferencat për shtyp | Zyra për Informim | | Konferencat për shtyp do të mbahet çdo dy muaj |
| Programe “vizito gjykatën” | Zyra për Informim Stafi administrativ Gjyqtarët | Organizatat e shoqërisë civile, shkollat e mesme, universitetet, grupet e komunitetit | Gjatë TM3 dhe TM 4 2014 do të realizohen katër programe “vizito gjykatës”, ndërsa nga vitit 2015 e tutje programet do të organizohen në baza mujore |
| Buletini informativ | Zyra për Informim Praktikantët | | Buletini informativ do të prodhohet çdo dy muaj |
| Ngjarje tematike | Zyra për Informim Stafi administrativ Praktikantët | Organizatat e shoqërisë civile | Ngjarjet tematike do të organizohen varësisht nga ditët e rëndësishme ndërkombëtare |
| Storiet e suksesit | Zyra për Informim Praktikantët | | Në secilin TM të vitit do të prodhohet së paku një storie e suksesit |
| Praktikantët e Zyres së Informimit | Zyra për Informim | Universitetet, organizatat e shoqërisë civile | Praktikantët do të angazhohen në TM4 2014, ndërsa nga fillimi i 2015 ZI do të ketë praktikantë gjatë gjithë kohës |
| Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë | Zyra për Informim | | Zyra për Informim do të prodhojë raporte gjashtë mujore për të vlerësuar zbatimin e strategjisë |

PËR GJYKATËN

Gjykata Themelore e Prizrenit është gjykata e parë ku qytetarët i fillojnë procedurat e tyre gjyqësore. Kjo gjykatë ka jurisdiksion të përgjithshëm, që do të thotë se ajo i gjykon të gjitha çështjet në shkallë të parë përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.

Gjykata Themelore e Prizrenit ka tri departamente dhe një divizion:

- Departamenti i Përgjithshëm, i cili merret me shumicën e lëndëve penale dhe civile dhe me rastet e kundërvajtjeve,
- Departamenti për të Mitur, i cili merret me lëndët në të cilat janë të përfshirë kryerësit e mitur,
- Departamenti për Krime të Rënda, i cili merret me lëndë që ceken në Nenin 15 të Ligjit për Gjykata dhe në Nenin 22 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, dhe
- Divizioni i Kundërvajtjes.

Kjo gjykatë i ka degët e saj në Suharekë dhe Dragash, të cilat i shqyrtojnë rastet që bëjnë pjesë vetëm brenda kompetencave të departamentit të përgjithshëm. Shërbimet administrative dhe mbështetëse të gjykatave janë riorganizuar në pesë zyra:

1. Zyra qendrore për menaxhimin e lëndëve,
2. Zyra për mbështetje juridike,
3. Zyra e financave,
4. Zyra për sigurim dhe logjistikë, dhe
5. Zyra për informim publik.

Qytetarët kanë ne dispozicion disa mundësi që t'i dorëzojnë gjykatës shkresat e tyre. Shkresat mund ti dorëzohen gjykatës:

- Personalisht;
- Përmes shërbimit postar;
- Çfarëdo mjeti tjetër të dorëzimit të shkresave.

Shpërndarja e lëndëve tek gjyqtarët bëhet me short. Të gjitha lëndët e pranuar brenda muajit kalendarik nga personeli i administratës së

gjykatës, ndahet në grumbuj sipas numrit të gjyqtarëve dhe llojit të lëmisë juridike gjyqësore. Ditën e regjistrimit, lënda i dërgohet gjyqtarit për shqyrtim. Shqyrtimi i lëndës nga gjyqtari shërben për t'iu shmangur vonesave në situatat e jo kompetencës së gjykatës.

Ndërsa, përjashtimi i gjyqtarit nga rasti bëhet me kërkesën e palës apo të gjyqtarit kur ekzistojnë arsyet ligjore, apo ka konflikt interesi, dhe për këtë vendos Kryetari i Gjykatës.

Te gjitha seancat gjyqësore janë të hapura për publikun, përveç në rastet e përcaktuara me ligj. Për të marrë pjesë mund të shihni:

- Tabelën e njoftimeve,
- Monitorin,
- Faqen e internetit, ose
- Kontaktoni zyrtarin për informim publik.

Një mundësi tjetër për t'u njohur me punën e gjykatës janë edhe "Ditët e Hapura" kur qytetarët mund të takojnë kryetarin e Gjykatës çdo dy javë, të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji.

Kontaktioni Gjykatën Themelore të Prizrenit

Zyra e Administratës
Tel: +381 (0) 29/244 122

Adresa
Gjykata Themelore e Prizrenit
Rr. "Ibrahim Lutfiu ", p.n.
Prizren, Kosovë

Vizito www.kgjk-ks.org